BALFIN
BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP

Përgjegjësia Sociale e Grupit Balfin

Fact Sheet-2015

Mbështetëm familjet e dëmtuara nga përmbytjet

Në Shkurt të vitit 2015, Balfin Group u solidarizua me familjet e dëmtuara nga përmbytjet duke u dhuruar pajisje elektroshtëpiake nga Neptun dhe veshje nga Fashion Group.

Mbështetëm Konkursin Kombëtar të TBU

Grupi Balfin mbështeti konkursin kombëtar të organizuar nga Tirana Business University ku në fund u shpallën dhe fituesit për çdo kategori.

TEG mbështet konkursin Albanian Skills

TEG ka qenë një mbështetës dhe promotor i konkursit Albanian Skills, konkurs kombëtar i cili synon që të nxjerrë në pah aftësitë e ndryshme të të rinjve shqiptarë.

U bëmë pjesë e iniciativës për pastrimin e Tiranës

Grupi Balfin i është bashkuar nismës së pastrimit të Tiranës duke kontribuar në pastrimin e zonave të ndryshme të qytetit.

Me programin Love Bag mbështetëm fëmijët në nevojë

Nëpërmjet rrjetit të dyqaneve OKAIDI, ndihmuam në përmirësimin e jetesës për fëmijët në nevojë e ata pa përkujdesje familjare.

Mbështetëm Fondacionin Down Syndrome Albania

Grupi Balfin ka bërë detyrën si biznes duke kontribuar në organizimin e eventeve gjatë muajit të Sindromës Down si dhe me kontributin në Ballon e Presidentit, fondet e së cilës kaluan për shoqatën Down Syndrome Albania.

Mbështetëm Artin

Gjatë vitit 2015 Grupi Balfin ka qenë një mbështetës i mirë i aktiviteteve dhe shfaqjeve teatrale dhe atyre të TKOB duke mundësuar blerjen e biletave për punonjës nga çdo shoqëri për të qenë pjesë e tyre.

U solidarizuam me Fshatin SOS

Uruam festat e fundvitit me kartolinat e përgatitura nga fëmijët e fshatrave SOS, e u kujdesëm të shpërndanim fjalën te bashkëpunëtorët tanë për të mbështetur nismën.

Mundësuam festën e Fundvitit për Shtëpinë e Foshnjes Korçë dhe Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër

Me suportin e shoqërisë AlbChrome, ushqimet tradicionale, dhuratat dhe programet argëtuese me këngëtarë, humoristë e akrobatë, sollëm buzëqeshje në fytyrat e fëmijëve dhe të moshuarve.

Dhuruam për fëmijët e policëve të vrarë

Përcollëm mesazhin se askush prej tyre nuk është vetëm në gëzimin e pragfestave.